

[Google Translate]

## VENDIM

**Nr.111, datë 26.1.2011**

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.486, DATË 25.7.2007 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR NDËRPRERJEN E VEPRIMTARISË SË PËRPUNIMIT TË ANIJEVE, QË TRANSFEROJNË NAFTË, GAZ DHE NËNPRODUKTE TË TYRE, NË PORTET E DURRËSIT DHE TË SHËNGJINIT", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 1 e 2 të ligjit nr.8450, datë 24.2.1999 "Për përpunimin, transportin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Në vendimin nr.486, datë 25.7.2007 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, togefjalëshi "të Shëngjinit", kudo ku është përdorur, shfuqizohet.
2. Në portin e Shëngjinit të fillojë veprimtaria e përpunimit të anijeve, që trajtojnë produkte dhe nënprodukte të naftës, sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi.
3. Përpunimi i anijeve, që trajtojnë produkte dhe nënprodukte të naftës në këtë port, të realizohet në përmbushje të standardeve shqiptare inxhinierike dhe ato të depozitohen në një terminal modern, të vendosur në distanca të përshtatshme me objektet publike ose private.
4. Për arsye sigurie, distanca minimale e terminalit depozitues nga pika e shkarkimit në këtë port të jetë jo më pak se 2 500 metra lineare.
5. Terminali depozitues të respektojë kushtet e sigurisë së jashtme, të brendshme, normat për mbrojtjen e mjedisit, si dhe kushtet e normat teknike në fuqi.
6. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministria e Punëve Publike dhe Transportit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**

**Sali Berisha**

Copyright 2016 - [www.liqjet.org](http://www.liqjet.org)